

VENDIM
Nr. 431, datë 22.6.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 75, DATË 12.2.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E MODELIT TË
FINANCIMIT TË BUXHETIT PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN
SHKENCOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 110, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 75, datë 12.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “c”, e pikës 2, të kreut III, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Koeficienti i prioriteteve ose financimi shtesë, në masën 50% për studentët që ndjekin studimet në programe prioritare, në masën 30% për studentët që ndjekin programe studimi të përbashkëta, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me IAL-të e shteteve të tjera, në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit të studimeve, dhe në masën 10% për studentët që ndjekin programe studimi me karakter profesional;”.

b) Pas pikës 2, të kreut V, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Fondet e miratuara për financimin e programeve të përbashkëta të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas marrëveshjeve të nënshkruara, në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit me institucionet e arsimit të lartë të shteteve të tjera, do të shpërndahen në bazë të kërkesave specifike që do të paraqesin IAL-të publike.

Institucionet publike të arsimit të lartë kërkojnë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin për përfitimin e financimit nga fondet grant për ndërkombëtarizimin, sipas thirrjes së shpallur nga ministria përgjegjëse për arsimin.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj